

VENDIM
Nr. 388, datë 13.5.2020

**PËR MIRATIMIN E LETËRMARRËVESHJES SË GRANTIT NR.TF0B1063,
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM/SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR
ZHVILLIM, QË VEPRON SI ADMINISTRATORE E FONDEVE GRANT TË
SIGURUARA NGA QEVERIA E KONFEDERATËS ZVICERANE, PËRFAQËSUAR
NGA SEKRETARIATI SHTETËROR ZVICERAN PËR ÇËSHTJET EKONOMIKE
(SECO), NË KUADËR TË FONDIT TË BESIMIT ME DONATORE TË VETËM
SECO, PËR FUQIZIMIN E KAPCITETEVE MBIKËQYRËSE TË AUTORITETIT
TË MBIKËQYRJES FINANCIARE NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e letërmarrëveshjes së grantit nr.TF0B1063, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve grant të siguruara nga qeveria e Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), në kuadër të fondit të besimit me donatorë të vetëm SECO, për fuqizimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Logo **BANKA BOTËRORE**

BERZH- IDA | GRUPI I BANKËS BOTËRORE

Shkëlqesisë së Saj, Anila Denaj, 20 dhjetor 2019
Ministre e Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë
Republika e Shqipërisë

Lënda: Grant i SECO-s nr.TF0B1063
Projekti i Fuqizimit të Kapaciteteve Mbikëqyrëse
Letër-Marrëveshje

Shkëlqesi,

Në përgjigje të kërkesës për asistencë financiare të bërë në emër të Republikës së Shqipërisë (“Marrësi”), me anë të letrës së datës 11 prill 2019 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, kam kënaqësinë t’iu informoj se Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (“Banka”), në cilësinë e administratorit të fondeve në formë granti të dhëna nga Qeveria e Konfederatës Zvicerane e përfaqësuar nga Sekretariati Shtetëror për Çështje Ekonomike (SECO) (“Donatori”), në kuadër të Fondit të Besimit me Donator të Vetëm SECO-Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri për Fuqizimin e Kapaciteteve Mbikëqyrëse, propozon t’i japë (“Vendit Anëtar”) një grant me vlerë jo më të madhe se nëntëqind e nëntëdhjetëmijë dollarë amerikanë (990.000 USD)

(“Granti”), sipas kushteve të parashikuara ose të cituara në këtë letër-marrëveshje (“Marrëveshja”), e cila përfshin Shtojcën bashkëlidhur, për të asistuar në financimin e projektit që përshkruhet në Shtojcë (“Projekti”).

Ky Grant mbështetet nga fondi i besimit i lartpërmendur për të cilin Banka merr kontribute periodike nga Donatori. Sipas Seksionit 3.02 të Kushteve Standarde (të parashikuara në Shtojcën e kësaj Marrëveshjeje), detyrimet e Bankës për të kryer pagesë në lidhje me këtë Marrëveshje nuk tejkalojnë shumën e fondeve, të cilat ia ka vendosur në dispozicion Donatori në kuadër të fondit të besimit të lartpërmendur dhe e drejta e Marrësit për të tërhequr fonde nga Granti varet nga disponueshmëria e fondeve në fjalë.

Me konfirmimin e miratimit të vet, më poshtë, Marrësi deklaron se është i autorizuar të lidhë këtë Marrëveshje dhe të realizojë Projektin sipas kushteve të parashikuara ose të cituara në këtë Marrëveshje.

Ju lutem konfirmoni miratimin e Marrësit për sa më lart, përmes vendosjes së nënshkrimit dhe datës në këtë Marrëveshje nga një zyrtar i autorizuar i Marrësit, dhe t’i ktheni Bankës një kopje të nënshkruar sipas rregullave. Me marrjen e kësaj kopjeje të siglur, kjo Marrëveshje hyn në fuqi duke filluar pasi Marrësi të ketë njoftuar për përfundimin e procedurave të tij të brendshme.

Me respekt,
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM DHE SHOQATA
NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM

Nënshkrimi
Maryam Salim
Drejtores e Zyrës së Bankës Botërore në Shqipëri
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

MIRATOI:
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nënshkrimi
Përfaqësuesi i Autorizuar
Emri Anila Denaj
Titulli Ministër i Financave dhe Ekonomisë
Data 15 prill 2020
Dokumentet bashkëlidhur:

1) “Kushtet standarde të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe të Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim për financimet në formë granti që jep Banka me mjetet e Fondeve të Besimit”, datë 25 shkurt 2019

2) Letër Disbursimi dhe Informacioni Financiar, me të njëjtën datë me të kësaj Marrëveshjeje, së bashku me “Udhëzimin për Disbursimin e Fondeve për Financimin e Projekteve të Investimit”, shkurt 2017

Grant i SECO-s nr.TF0B1063
SHTOJCË

Neni 1
Kushtet standarde: Përkufizime

1.01. Kushtet standarde. Kushtet Standarde (siç përkufizohen në seksionin 1.02 në poshtë) përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

1.02. Përkufizime. Nëse nuk e kërkon ndryshe konteksti, termat që fillojnë me shkronjë të madhe në këtë Marrëveshje kanë kuptimin e vendosur për to në Kushtet Standarde ose në këtë seksion:

a) “Autoriteti Shqiptar i Mbikëqyrjes Financiare” ose “AMF” është Autoriteti shqiptar i Mbikëqyrjes Financiare, një institucion i pavarur publik, i cili është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit nr.9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, ose çdo subjekt pasardhës i tij i caktuar në mënyrë ligjore.

b) “Udhëzimet anti-korrupsion”, për qëllime të paragrafit 2 të shtojcës së Kushteve Standarde, janë “Udhëzimet për parandalimin dhe luftën kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit në projektet e financuara me hua të BNRZH-së dhe kredi e grante të SHNZH-së”, datë 15 tetor 2006, rishikuar në janar 2011 dhe nga data 1 korrik 2016.

c) “Kategoria” është një kategori e përcaktuar në tabelën në seksionin 3.01 të kësaj Marrëveshjeje.

d) “Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të Tjerë” ose “DPFK” është Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të Tjerë në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të Marrësit ose çdo pasardhës ligjor i saj.

e) “Kostot operative” janë kostot e arsyeshme, të miratuara nga Banka, për shpenzime shtesë të lindura për llogari të zbatimit të Projektit, kostot e komunikimit dhe sigurimit, komisionet bankare, fotokopjimi/printimi i dokumenteve, mallrat e konsumit, kostot e udhëtimit dhe dietat për personelin e Projektit për udhëtimet e kryera në lidhje me zbatimin e projektit.

f) “Rregullat për prokurimet” janë, në kuptim të paragrafit 20 të Bashkëlidhjes së Kushteve Standarde, “Rregullorja e Bankës Botërore për prokurimet për huamarrësit e financimeve të projekteve të investimeve”, korrik 2016, rishikuar në nëntor 2017 dhe në gusht 2018.

g) “Kushtet Standarde” janë “Kushtet standarde të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe të Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim për financimet në formë granti që jep Banka me mjetet e Fondeve të Besimit”, datë 25 shkurt 2019.

h) “Trajnimi” janë kostot e arsyeshme, të miratuara nga Banka, për trajnimin e kryer në kuadër të Projektit, duke përfshirë pagesën e mësimit, kostot e udhëtimit dhe qëndrimit për pjesëmarrësit në trajnim, kostot e lidhura me gjetjen e shërbimeve të trajnuesve, lektorët, qiraja e mjediseve dhe mjeteve të trajnimit, përgatitja dhe riprodhimi i materialeve të trajnimit dhe kosto të tjera të lidhura drejtpërdrejt me përgatitjen dhe zbatimin e kursit të trajnimit (por pa përfshirë mallrat dhe shërbimet e konsulentëve).

Neni 2

Zbatimi i Projektit

2.01. Objektivat dhe përshkrimi i Projektit. Objektivi i Projektit është fuqizimi i kapacitetit të AMF-së për të rregulluar dhe mbikëqyrur tregjet e kapitalit, dhe fuqizimi i zhvillimit të tregjeve për produktet e tregjeve të kapitalit nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit financiar dhe nxitjes së novacionit financiar.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Komponenti 1: Fuqizimi i funksioneve rregullatore dhe mbikëqyrëse të AMF-së

Mbështetje për përgatitjen e rregulloreve dhe udhëzimeve përkatëse në lidhje me ligjin e sapomiratur për tregjet e kapitalit në Shqipëri.

Komponenti 2: Fuqizimi i mbikëqyrjes me bazë riskun për Tregjet e Kapitalit nga AMF-ja:

a) Fuqizimi i kapacitetit të AMF-së për administrimin dhe mbikëqyrjes me bazë riskun, mes të tjerash nëpërmjet: i) dhënies së informacionit mbi llojet e të dhënave që duhen mbledhur dhe analizën kundrejt risqeve të sistemit dhe ii) kryerjes së aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve në lidhje me përdorimin e këtyre të dhënave për përgatitjen e raporteve në funksion të mbikëqyrjes.

b) Zhvillimi i një mjedisi të administrimit të risqeve brenda institucionit, ndër të tjera nëpërmjet: i) krijimit të një regjistri të risqeve dhe hartimit të rregulloreve për këtë qëllim; dhe ii) kryerjes së aktiviteteve të ngritjes së kapaciteteve/ndërgjegjësimit me palë interesi dhe punonjës të përzgjedhur në lidhje me një mjedis të tillë të administrimit të risqeve.

Komponenti 3: Zhvillimi i kapacitetit të AMF-së për të monitoruar dhe mbikëqyrur tregjet e letrave me vlerë:

a) Fuqizimi i kapacitetit të AMF-së për inspektim, hetim dhe zbatim në lidhje me tregjet e letrave me vlerë dhe fondeve të investimeve, ndër të tjera nëpërmjet: i) ofrimit të trajnimit në detyrë për inspektimin e agjencive të administrimit të aktiveve të fondeve të investimeve dhe të depozitarëve; dhe ii) përgatitjes së një manuali të zbatimit, duke përfshirë financimin e aktiviteteve të ngritjes së kapaciteteve dhe vizitave të shkëmbimit në tregje më të përparura me kuadër të ngjashëm ligjor.

b) Mbështetja e AMF-së për t'i zhvilluar kapacitetet për monitorimin e aktiviteteve të tregjeve të kapitalit për të zbuluar dhe parandaluar manipulimet e tregut dhe abuzimet e tregut, ndër të tjera nëpërmjet: i) përgatitjes së një raporti ku të përshkruhen nevojat e AMF-së për një sistem të mbikëqyrjes së tregut, duke përfshirë identifikimin e specifikimeve për një sistem të tillë; dhe ii) ngritjes së kapaciteteve të punonjësve të përzgjedhur të AMF-së për monitorimin e aktiviteteve të tregjeve të kapitalit.

c) Dhënia e mbështetjes rregullatore dhe mbikëqyrëse, trajnimit dhe orientimit për AMF-në.

Komponenti 4: Mbështetja e AMF-së në punën për zhvillimin e tregjeve të kapitalit:

Dhënia e asistencës teknike AMF-së: (a) në kryerjen e aktiviteteve të përzgjedhura në lidhje me ndërgjegjësimin dhe edukimin financiar, për të arritur një rezultat të identifikueshëm dhe të qëndrueshëm në kohë; dhe (b) për trajtimin e mundësive dhe vështirësive që lindin nga rritja e përdorimit të teknologjisë nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në treg; dhe asistimi i AMF-së për të përgatitur dhe shpërndarë një dokument për politika në lidhje me përdorimin e novacionit financiar në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve në tregjet e kapitalit.

Komponenti 5: Menaxhimi dhe zbatimi i projektit:

Mbështetje për administrimin dhe zbatimin e projektit.

2.02. Realizimi i Projektit në përgjithësi. Marrësi deklaron angazhimin e tij për objektivat e Projektit. Për këtë qëllim, Marrësi e realizon Projektin nëpërmjet AMF-së dhe DPFK-së, në përputhje me dispozitat e: (a) nenit II të Kushteve Standarde; (b) Udhëzimeve Anti-korrupsion; dhe (c) këtij neni II;

2.03. Masat organizative institucionale dhe të tjera.

a) Për qëllime të realizimit të Projektit, Marrësi, nëpërmjet AMF-së: i) është përgjegjës për zbatimin, menaxhimin, bashkërendimin dhe kontrollin mbikëqyrës, në përgjithësi, të Projektit; dhe ii) mban, në çdo moment, gjatë zbatimit të Projektit, numrin e mjaftueshëm të punonjësve me detyra, kualifikime dhe përvojë të pranueshme për Bankën.

b) Pa u kufizuar tek dispozitat e shkronjës "a" të Seksionit 2.03 më lart, Marrësi garanton që gjatë të gjithë zbatimit të Projektit, DPFK: i) i jep AMF-së, së cilës i është ngarkuar zbatimit teknik i Projektit, mbështetje për prokurimin, drejtimin financiar dhe monitorim-vlerësimin; dhe ii) mban, në çdo moment, gjatë zbatimit të Projektit, numrin e mjaftueshëm të punonjësve me detyra, kualifikime dhe përvojë të pranueshme për Bankën.

Neni 3

Tërheqja e fondeve të Grantit

3.01. Shpenzimet e lejuara. Marrësi mund t'i tërheqë fondet e Grantit sipas dispozitave të: (a) nenit III të Kushteve Standarde dhe (b) këtij seksioni; për të financuar shpenzimet e lejuara sipas shumës së caktuar dhe, nëse zbatohet, deri në përqindjen e përcaktuar kundrejt secilës kategori të tabelës së mëposhtme:

Kategoria	Shuma e shpërndarë e Grantit (shprehur në USD)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përfshirë tatimet)
1) Shërbimet e konsulencës, trajnimet dhe kostos operative	990.000	100%
SHUMA TOTALE	990.000	

3.02. Kushtet për tërheqjen. Pavarësisht dispozitave të seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje, nuk mund të kryhet asnjë tërheqje për pagesat e kryera para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

3.03. Periudha e tërheqjes. Data e mbylljes është 31 dhjetor 2022.

Neni 4

Përfaqësuesi i Marrësit; Adresat

4.01. Përfaqësuesi i Marrësit. Përfaqësuesi i Marrësit, i përmendur në seksionin 7.02 të Kushteve Standarde, është ministri përgjegjës për financat në atë kohë.

4.02. Adresa e Marrësit. Për qëllime të seksionit 7.01 të Kushteve Standarde:

a) Adresa e Marrësit është:

Ministri i Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi Dëshmorët e Kombit, nr. 3
Tiranë

Republika e Shqipërisë; dhe

b) Adresa elektronike e Marrësit është:

Sekretariamin@financa.gov.al

4.03. Adresa e Bankës. Për qëllime të Seksionit 7.01 të Kushteve Standarde:

a) Adresa e Bankës është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe
Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim
1818 H Street, N.W. Washington, D.C. 20433
United States of America; and

b) Adresa elektronike e Bankës është:

jjaeger@worldbank.org, kgjika@worldbank.org